



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

**K.DH.SH.II.nr.1463/22**

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të sigurimit “A...” me nr. biznesi ....., Slloveni, përfaqësuar nga J.P Administrator Falementues e që sipas autorizimit të dt.09.07.2021 e përfaqëson sipas autorizimit B.D.H avokat nga Prishtina, ndaj kundërshtarit të sigurimit “O...”, me seli në Prizren, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N.M avokate nga Prizreni, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit për sigurimin e provës e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.27/22 e dates; 26.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën; 12.09.2022, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e propozuesit të sigurimit “A...” me nr.biznesi ....., me seli në Slloveni, dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.27/22 e datës 26.04.2022.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor I.EK.nr.27/22 e datës;26.04.2022, ka vendosur si në vijim;

“Refuzohet në tërësi si e pa bazuar propozimi i propozuesit “A...” me nr.biznesi ....., me adresë të selisë në Slloveni, i paraqitur kundër kundërpropozuesit “O...”, L.L.L, me numër identifikues ....., me seli në Prizren, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të bëhet sigurimi i provës-ashtu që të detyrohet kundërpropozuesi që t’ia dorëzoj në gjykatë tri kopje të kontratave të lidhura me IATA.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i sigurimit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore,dhe për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar ta anulon , dhe lëndën ta kthej në rivendosje .

Kundërpropozuesi ka paraqitur përgjigje në ankesë, me të cilën ka kërkuar që ankesa e propozuesit të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

**-Ankesa është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesja e sigurimit “A...”, me nr.biznesi ....., me adresë të selisë në Slloveni , në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi dhe kërkesë për sigurimin e provës , duke theksuar se paditësja është kompani ajrore me seli në Zgornji Brnik të Sllovenisë dhe ka marrëveshje të kliringut në Shoqatën Ndërkombëtare të transportit ajror të njohur ndërkombëtarisht IATA . Paditësi përmesë marrëveshjes ka pasur për detyrë që të mundësojë të gjitha agjensioneve që janë pjesë e IATA-as përfshirë këtu edhe të paditurën që ti mundësoj paisjen/blerjen e biletave për transportin ajror të udhëtarëve, ndërsa i padituri/agjensioni ka pasur për obligim që të kryej pagesën përmes sistemit të përbashkët, ndër të tjera ka shtuar se me datën 30.09.2019 i padituri është njohftuar nga IATA mbi pezullimin e veprimtarisë të paditurës si dhe ka kërkuar nga i padituri që të gjitha detyrimet ndaj paditëses ti bëj direkt paditësit, andaj mbi këtë bazë ka kërkuar që të aprovohet kërkesa e propozuesit “A...” me nr.biznesi ....., me adresë të selisë qendërore në Slloveni dhe ta detyroj kundërpropozuesin që brenda 3 ditësh nga marrja e këtij aktvendimi të parashtron në 3 kopje kontratat të lidhura me IATA.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për sigurinë e provës ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe pretendimet me shkrim nga ndërgjyqësit sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe ka marr aktvendimin e ankimuar me arsyetim se nuk është plotësuar anjëra nga kushtet e parpara në nenin 379 të LPK-së,se nga provat e propozuara duhet të varet zgjidhja e kontestit apo prova e propozuar të ndikoj në sqarimin e rrethanave vendimtare të kontestit dhe paraqitja e rrezikut të zhdukjes së provës apo e vështirësisë në nxjerrjen e saj, kështu kjo provë mund të nxirret gjatë gjykimit të rregullt, nëse gjykata do ta vlerësojë në ndërkohë si një provë e nevojshme për ndriçimin e fakteve vendimtare të rastit.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Dhomës së Shkallës së Dytë e mori këtë vlerësim juridik për arsye se sipas nenit 379 pikën 1) të LPK-së parashihet se; *“Kur një provë, nga e cila varet zgjedhja e kontestit ose që ndikon në sqarimin e tij, ka rrezik të zhdukjet ose të vështërsohet marrja e saj, me kërkesën e palës së interesuar mund të udhërohet marrja para kohe e saj, qoftë gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, qoftë para fillimit të tij”*.

Bazuar në dispozitën e sipërcituar lidhur me sigurimin e provës duhet të plotësohen kushtet ligjore, ashtu që nëse rrethanat tregojnë se një provë nuk do të mund të merret në seancën për shqyrtimin kryesor ose marrja e saj do të jetë e vështirësuar, e që në rastin konkret propozuesi nuk

e ka argumentuar në mënyrë që propozimin e tij ta bëjë të bazuar apo se prova e propozuar për sigurim mund të ndikojë në sqarimin dhe zgjedhjen e kontestit, kështu provën me të cilën kërkon propozuesi i sigurimit nuk paraqet rrezikë të zhdukjes së provës apo vështërsisë në nxjerrjen e saj, ngase një provë e till mund të nxjerrët gjatë gjykimit të rregullt, ngase një kontratë nuk mund ta ketë vetëm kundërpropozuesi por edhe pala tjetër si që është IATA.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ka gjetur se propozimi është i pabazuar, ka mbështetje ligjore si dhe janë dhënë arsyet e justifikueshme të bazuara në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerësoj edhe pretendimet ankimore të propozuesit të sigurimit lidhur me at se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 102 par 1 të LPK-së, ngase nuk e ka thirrë në seancë dëgjimore në mënyrë që propozuesit të ketë mundësi ta plotësoj propozimin nëse gjykata ka vlerësuar se propozimi ka qenë jo i plotë, një pretendim të till gjykata e refuzoj si të pa bazuar ngase dispozita e nenit 102 paragrafi 1 të LPK-së ka paraparë se “ *Kur një parashtresë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korigjojë ose ta plotësoj parashtresën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korigjimin dhe për plotësimin e parashtresës.*” E që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar se propozimi është e pa kuartë, por ka vendosur ta refuzoi kërkesën për sigurimin e provës duke vlersuar se marrja e një prove të till mund të nxjerrët gjatë gjykimit të rregullt nëse gjykata do të vlerësoj në ndërkohë si një provë e nevojshme për ndriqimin e fakteve vendimtare të kësaj çështje, andaj një pretendim i till është në kundërshtim me dispozitën e sipër cituar.

Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoj edhe pretendimet e tjera ankimore të propozuesit të sigurimit por gjeti se të njejtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi i gjykatës së parë.

Prandaj, bazuar në të lartëcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njehta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parpara me dispozitën e nenit 379.1 të LPK-së, për sigurimin e provës. Nga të cekurat më lartë e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.1463/22,data; 12.09.2022**

Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja  
Franciska Zhitija Ymeri

